

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretarën juridike Suzana Kovaçević, në lëndën penale kundër të akuzuarit Z.A. nga fsh, ..., kom. e ..., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragr.1 KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1474/17 të datës 25.08.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më dt. 30.01.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I pandehuri Z.A. nga babai A. dhe nëna S., e lindur H., i lindur më dt. ... në ..., jeton në fsh. ..., kom. e ..., i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer 2 klasë të shkollës fillore, i papunë, pranon ndihmë sociale, i gjendjes së dobët ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

Ë S H T Ë F A J T O R

sepse më dt. 08.08.2017 rreth orës 20:10 minuta, në periferi të fsh. ... kom. e Gjilanit, në pyllin shtetëror në v.q. “ ... ” i pandehuri Z.A. me qëllim që vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka vjedhur dru, në atë mënyrë që me sharrë motorike i ka pre 140 trungje të llojit “shkozë” dhe “ah” me diametër në cung 10-14 cm, me lartësi të drurit 9-10 cm, gjatësia 6 metra, me vëllim të përgjithshëm prej 3.79 m³, dhe në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta të dëmtuarës ... në Gjilan, i ka shkaktuar dëm në shumë prej 579.87 €.

- me çka ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 paragr.1 KPRK.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4,41,42,49,50,51,52, 73 dhe 74 KPRK si dhe nenit 248 dhe 365 KPPK të pandehurit i shqipton

DËNIMIN ME KUSHT

I. Të pandehurit i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 2(dy) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës kohore prej 1(një) viti, nuk kryen tjetër vepër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

II. E dëmtuara ... nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pronësoro-juridike është udhëzuar në kontestin civil.

III. Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 25 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzën penale kundër të akuzuarit Z.A. nga fsh. ..., kom. e ..., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni nga neni 358 KPRK.

Gjatë seancës fillestare të mbajtur më dt. 30.01.2018 në të cilën është lexuar aktakuza e Prokurorisë së shtetit PP.II.nr.1474/17 e dt. 25.08.2017, dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri Z.A. deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale e cila i vihet në barrë, duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale. Në mbrojtjen e tij i akuzuari deklaroi se i ka pre drutë e cekura më lart me qëllim që për disa ditë të ushqej familjen e tij, sepse ka katër fëmijë dhe që të gjithë shkojnë në shkollë. Jeton me familjen njëmbëdhjetë anëtarësh dhe që të gjithë varen na ky, kështu që është i detyruar të bëjë vepra të tilla, sepse jeton nga ndihma sociale e cila nuk është e mjaftueshme për të ushqyer familjen e vet. Pranon se veprën e ka kryer nga nevoja e madhe për të shpëtuar ekzistencën. Në mbrojtjen e tij më tej deklaroi se është i paarsimuar dhe se askush nuk dëshiron ta pranojë në punë për të pasur mundësi të pranojë rrogë të rregullt. pendohet për veprën e kryer penale dhe se më parë nuk ka qenë i gjykuar, i vjen keq për veprën e bërë, i ka premtuar gjykatës se nuk do të kryej vepra penale dhe se nuk do të prej dru në pyll, andaj, e lutë gjykatën që ta dënoj sa më butë.

Në seancën e parë fillestare dhe publike, gjykatësja e vetme gjykuese mori Aktvendim me të cilin aprovoi pranimin e fajësisë, pasi që ka konstatuar se për këtë gjë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Gjykatësja e vetme ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi është bërë me vullnetin e tij, se pranimi i fajësisë përmban të gjitha faktet të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurorja nuk pati kurrfarë vërejtje lidhur me pranimin e fajësisë dhe konsideron se për këtë janë plotësuar të gjitha kushtet.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës kurse me vetë faktin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, ka ardhur në përfundim se i akuzuari Z.A. ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358.paragr.1KPRK.

Bazuar në nenin 73 dhe 74 KPRK me rastin e shqiptimit të dënimit kundër të pandehurit, gjyqtarja e vetme gjykuese mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që nga rrethanat lehtësuese mori parasysh faktin se i pandehuri është baba i katër fëmijëve, sjelljen e tij korrekte në gjykatë, se deri më sot nuk ka qenë i gjykuar, se është i gjendjes tejet të dobët ekonomike, se është mbajtës i familjes njëmbëdhjetë anëtarësh i papunë dhe se veprën e ka kryer sepse ka qenë i detyruar dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të kryej vepra penale. Nga rrethanat rënduese gjykata mori parasysh rrezikshmërinë shoqërore dhe faktin se kjo vepër është mjaft e shpeshtë.

Sipas bindjes së kësaj gjykate shqiptimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurit Z.A., është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit. Gjykata konstatoi se me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit nga neni 41 KPRK që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra tjera penale, t'i parandaloj personat tjerë në kryerjen e veprave penale dhe të paraqes gjykimin shoqëror për veprën penale, të rris moralin dhe fuqizoj obligimin për të respektuar ligjin.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.856/2017 më dt. 30.01.2018

Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçeviq, d.v.

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajllloviq, d.v.

UDHËZIMI JURIDIK: *Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.*

Përktheu –
Naile Keçmezi

